



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. Nr. 906/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 36 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01/2017, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga autoriteti kontraktues (AK) “Komuna e Obiliqit”, për diskualifikim të Operatorit Ekonomik “NPN ADRA”- Prishtina nga pjesëmarrja në prokurim publik me arsyetimin se OE në fjalë nuk ka arritur të zhvillojë punimet e parapara sipas marrëveshjes së bërë për këtë aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi dhe mirëmbajtja e stacioneve të qytetit”, me numër të prokurimit: “614/17/026/536”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) / Komuna e Obiliqit /, më: 26.10.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet, si e pa bazuar, kërkesa e Autoritetit Kontraktues (AK) / Komuna e Obiliqit /, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE “NPN ADRA”- Prishtinë, lidhur me procedurën e prokurimit me titull “Ndërtimi dhe mirëmbajtja e stacioneve të qytetit”, me numër të prokurimit: “614/17/026/536”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) /Komuna e Obiliqit/.

A R S Y E T I M

Autoriteti Kontraktues / Komuna e Obiliqit / me dt: 17.10.2017, ka parashtruar kërkesë në OSHP, që të shqyrtohen mundësit e veprimit konform nenit 99 të LPP-së, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik dhe marrje të masave ndaj OE “NPN ADRA”- Prishtinë.

Përkitazi me kërkesën e lartpërmendur OSHP-ja ka mbajtur seancën dëgjimore me dt: 26.10.2017, ku prezent ishin paneli shqyrtues, ekspertja shqyrtuese e OSHP-së, ndërsa përfaqësuesit e AK-së dhe OE nuk ishin prezent gjatë seancës edhe pse ishin ftuar në mënyrë të rregullt.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës dëgjimore, konstaton se LPP-ja nuk e ka paraparë që operatorët ekonomik mund të diskualifikohen nga pjesëmarrja në prokurimin publik me arsyetimin se operatori ekonomik nuk ka arritur të zhvillojë punimet e parapara sipas marrëveshjes së bërë, pasi që pas nënshkrimit të kontratës palët hyjnë në obligime kontraktuale dhe aty parashihen detajet dhe kompetencat në rast të mospërbushjes së kontratës. Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues nuk ka ofruar asnjë dëshmi relevante për diskualifikim të OE "NPN ADRA"- Prishtinë ashtu siç parashihet në nenin 99 paragrafi 2 të LPP-së, prandaj kërkesa e AK-së për diskualifikim të këtij operatori ekonomik nuk është e bazuar.

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - "Komuna e Obiliqit"
- 1x1 OE - "NPN ADRA" - Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.